



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 83/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Gazmend Vata anëtarë i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të pengimit gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012 në ora 09:40, në shkollën “Ahmet Hoxha” në vendvotimin 09/R, ka hyrë një person që të qëndrojë në Vendvotim duke u arsyetuar kinse po ju dërgon bukë komisionarëve dhe vëzhguesve të PDK-së, mirëpo nuk kishte bukë me vete. Sipas parashtruesit të ankesës emri i këtij personi është Gazmend Vata, ndërsa në bexh i shkruante “Faruk”. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla zgjedhore 9/2008 neni 2.8 dhe LZP neni 82.3 pika a) dhe b), si dhe neni 117 i Kodit penal. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur foton nga vendi i ngjarjes

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 29.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e LVV-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 30.04.2012, në ora 12:00.

PZAP-i, me datën 30.04.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga PDK lidhur me ankesën e paraqitur nga LVV-ja, në të cilën theksohet se pretendimet e subjektit politik LVV se kinse në shkollën fillore “Ahmet Hoxha” një vëzhgues ka qenë me ID kartë të rrejshme, ju njoftojmë se personi në fjalë nuk ka të bëjë asgjë me realitetin sepse personi në fjalë as që është në listën e vëzhguesve të PDK-së dhe është person i panjohur për subjektin ton politik dhe kjo është vetëm një insinuatë nga subjekti LVV, më tej në përgjigjen thuhet nëse nevojitet prova materiale për vëzhguesit e certifikuar jemi në gjendje ti ofrojmë.

Në raportin e policisë të datës 30.04.2012, të lëshuar nga oficerja policore Selvie Ismani theksohet se me datën 29.04.2012 në ora 04:00, kemi qenë të caktuar në shkollën "Ahmet Hoxha" në vendvotime policët Selvije Ismani, Rasim Rushiti dhe Habib Mehmeti, rreth orës 14:00, ka ardhur komisionari Valon Ramadani, i cili ka kërkuar nga ne që të hyjmë brenda në shkollë dhe të largojmë një person i cili dyshohej se ka hyrë brenda në QV-së, me arsyen se iu kishte sjellë ushqim një subjekti politik, mirëpo sipas ankuesit ushqim nuk kishte me vete dhe ID kartën bezhin e kishte të falsifikuar. Sipas raportit të policisë, pas intervenimit që kanë bërë nuk kanë mundur ta hasim personin e dyshuar, dhe nga vetë ankuesi jemi njoftuar se personi i dyshuar është larguar nga QV-ja. Ne kemi njoftuar Lima kontrollin, më pas kemi kontaktuar Drejtorin e kësaj shkolle njëkohësisht përgjegjës për QV, i cili ka pohuar se gjithçka është në rregull.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për ti vërtetuar pretendimet ankimore, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë të datës 30.04.2012, në të cilën theksohet se gjatë vizitës që është bërë nga policia e Kosovës në vendin e ngjarjes nuk kanë hasur personin në fjalë si dhe në bazë të kontaktit me drejtorin e shkollës njëkohësisht përgjegjës për këtë QV, ka konfirmuar se nuk ka pasur ndonjë parregullsi gjatë procesit të votimit, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 83/2012 më datën 03.05.2012.

